



Prishtinë, 23 dhjetor 2013
Kodi i ZRRE-së: V_584_2013

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna me Nenin 14 pika 2.6 dhe Nenin 43, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.03/L-185;
- Dispozitat e Nenit 17 të Ligjit për Energjinë Nr. 03/L-184; dhe
- Shkresën / Njoftimin e Ngrohtores së Qytetit (NQ) Termokos SH.A të datës 23 tetor 2013 lidhur me vendimin e tyre për të mos aplikuar për ngritjen e tarifave;

në seancën e mbajtur me datë 23 dhjetor 2013, nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHEN** tarifat e ngrohjes qendrore për Ngrohtoren e Qytetit (NQ) Termokos SH.A. për sezonin e ngrohjes 2013/2014, siç janë paraqitur në tabelat "A" dhe "B".

Arsyetim

- Me datën 23 tetor 2013, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar shkresën nga Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Termokos SH. A, me anë të së cilës njoftohet ZRRE-ja se, menaxhmenti i NQ Termokos, në koordinim me Bordin e drejtorëve, ka marrë vendim që të mos aplikoj për ngritjen e tarifave për sezonin 2013/2014. Në këtë njoftim gjithashtu theksohen edhe arsyet për një vendim të tillë:
 - Rikthimi i besimit të konsumatorëve, i cili është cenuar gjatë sezonit të kaluar kur NQ Termokos ka dështuar që t'ju siguroj konsumatorëve furnizim të qëndrueshëm dhe kualitativ;
 - Rritja e tarifave në këtë situatë do të ndikonte negativisht në arkëtimin e pagesave nga konsumatorët – përkundrazi, vlerësohet se zbatimi i tarifave ekzistuese, si dhe furnizimi që pritet të përmirësohet sidomos me përfundimin e projektit të ko-gjenerimit, do të ndikoj pozitivisht në shtimin e shkallës së arkëtitimit të pagesave.
- Për vendosjen e tarifave të ngrohjes qendrore, ZRRE ka marr parasysh arsyetimet e paraqitura në shkresën e NQ Termokos të datës 23 tetor 2013, të cilat i ka konsideruar të drejta dhe të argumentuara.
- Duke marr parasysh dispozitat ligjore të theksuara në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e shkresës së NQ Termokos të datës 23 tetor 2013, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



- II. Struktura e tarifave të Ngrohtores së Qytetit Termokos SH. A ,për sezonin e ngrohjes 2013/2014 është dhënë në tabelën e mëposhtme:

**TARIFAT PËR NGROHTOREN E QYTETIT TERMOKOS SH.A
PËR SEZONIN E NGROHJES 2013/2014**

Tabela A . TARIFA PËR KONSUMATORËT PA MATJE

| NGROHTORJA E QYTETIT TERMOKOS SH.A. | | |
|---|-----------------------------------|--|
| Komponentet e Tarifave | Konsumatorët shtëpiakë | Konsumatorët Komercialë e Institucionalë |
| Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse) | 0.07 [€/m ² për muaj] | 0.08 [€/m ² për muaj] |
| Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile) | 0.77 [€/m ² për muaj] | 0.92 [€/m ² për muaj] |

Tabela B .TARIFA PËR KONSUMATORËT ME MATJE

| NGROHTORJA E QYTETIT TERMOKOS SH.A | |
|--|----------------------|
| Tarifa mujore e kapacitetit të ngrohjes (komponenta fikse) | 0.66 [€/kW për muaj] |
| Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile) | 45.50 [€/MWh] |

- III. NQ Termokos SH. A duhet ta publikoj këtë vendim, brenda pesë (5) ditëve të punës pas marrjes së vendimit dhe publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, në së paku një prej gazetave ditore me qarkullim të gjerë në Kosovë.
- IV. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejtë që të auditoj regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Termokos SH.A. për të verifikuar realizimin e të Ardhurave dhe Kostove në sezonin 2013/2014.
- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërbëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, Kryesues

Merita Kostari, Anëtare

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar

Krenar Bujupi, Anëtar